




TEMPULLI



Rr. Eduard Lir 158, Arbëria
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038 22 22 55, 038 60 40 20
Fax: 038 60 40 19
Web: www.tempulli.org
Email: info@tempulli.org

Kryesuesi i Këshillit Akademik

Nr.Prot: _____, Data e aprovimit: 29.01.2025, Version i rishikuar

Prof. Dr. Sc. Mevlan Bixhaku

Në bazë të nenit 34, të Statutit të Kolegjit Tempulli dhe nenit 3, paragrafi 1.9 të rregullores së punës së Këshillit Akademik në mbledhjen e mbajtur më 29.01.2025 Këshilli Akademik miratoj këtë:

RREGULLORE PER STUDIME THEMELORE (BACHELOR) NË KOLEGJ

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me Rregullore të studimeve themelore (bachelor) (në tekstin e mëtejme: "Rregullore") në Kolegjin Tempulli (në tekstin e mëtejme Kolegji) përcaktohen dhe rregullohen çështjet si në vijim:

1. Kriteret e pranimi të studentëve;
2. Organizimi i studimeve;
3. Kushtet e regjistrimit të vitit akademik;
4. Kohëzgjatja e studimeve;
5. Përfundimi i studimeve dhe punimi i diplomës;
6. Statusi i studentit;
7. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve;
8. Dispozitat kalimtare.

II. Kriteret e pranimi të studentëve

Neni 2

Kandidatët mund të regjistrohen në programet e studimit të cilat i ofron Kolegji.

Regjistrimi i studentëve në programet e studimit bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara nga MASHT-i dhe Këshilli Akademik si dhe konkursit publik të shpallur nga Këshilli Drejtues i Kolegjit.

Neni 3

Nuk do të ketë kufizime moshe për t'u regjistruar apo të marrë kualifikim të arsimit të lartë.

Neni 4

Të gjithë kandidatët që kalojnë testin e maturës, gëzojnë të drejtën për të aplikuar në studime në Kolegj.

Në Kolegj mund të regjistrohen kandidatët të cilët kanë mbaruar shkollën e mesme, pa maturë, të vërtetuar me diplomë përkatëse, por që i nënshtrohen provimit pranues.

Për studimet themelore mund të regjistrohen kandidatët të cilët i plotësojnë këto kushte:

- Përfundimi me sukses i shkollës së mesme në Kosovë i vërtetuar me diplomë;
- Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku 12 vjet të shkollimit vërtetuar me diplomë përkatëse;
- Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku 12 vjet të shkollimit vërtetuar me diplomë përkatëse të fituar në botën e jashtme, në qoftë se është bërë barasvlerësimi me certifikatën e maturës;
- Vendimi për njohjen e diplomës dhe barasvlerën merret nga Ministria përkatëse.

Neni 5

Zgjedhja e kandidatëve të paraqitur në konkurs bëhet sipas kritereve të vendosura nga Këshilli Akademik për çdo vit.

Në rastet kur Kolegji bënë pranimin e kandidatëve përmes provimit pranues, kandidati ka të drejtë të paraqesë ankesë te Koordinatori i programit dhe këtë të drejtë mund ta ushtroj në afatin prej 48 orë nga dita e shpalljes së rezultateve. Brenda këtij afati kandidati ka të drejtë të shoh punën e tij (në rastet kur ka provim pranues).

Kundër listës së rangimit, kandidati ka të drejtë të paraqesë ankesë te Koordinatori i programit dhe këtë të drejtë mund ta ushtroj në afatin prej 48 orë nga dita e shpalljes së rezultateve.

Neni 6

Dokumentet e nevojshme për të konkurruar në studimet bachelor janë:

- Fletëregjistrimi me dy fotografi
- Kopja e letërnjoftimit
- Diploma (origjinale ose e noterizuar) e kryerjes së shkollës së mesme
- Certifikata e testit të maturës
- Dëftesat e shkollës së mesme
- Certifikata e lindjes

- Në rast se studenti ka mbaruar shkollimin e mesëm jashtë vendit duhet nostrifikimi i dokumenteve.

Dokumentet që i paraqet studenti me rastin e regjistrimit mbeten në shërbimin e administratës së Kolegjit deri në përfundimin e studimeve apo edhe në rast të ndërprerjes së studimeve.

Shërbimi i administratës e bënë regjistrimin e studentëve të rijnë në librin amzë dhe në sistemin elektronik për menaxhimin e studentëve dhe formon dosjen e studentëve me numër rendor përkatës varësishtë nga viti akademik i regjistrimit.

Neni 7

Studenti duhet të ketë kompletuar procedurën për regjistrim, që përfshin:

- Aplikim online;
- Dorëzim të dokumenteve sipas konkursit;
- Përmbyllje të të gjitha kushteve për regjistrim;
- Realizim të pagesës së shkollimit.

Kushtet dhe kriteret tjera për praninë dhe regjistrim në vitin përkatës përcaktohen me vendim të veçantë.

Regjistrimin e studentëve në semestrin e parë në bazë të konkursit e bënë administrata e Kolegjit, të dhënat menaxhohen nga Kolegji, duke u respektuar ligji i privatësisë dhe duke u dhënë studentëve udhëzuesit për punën dhe funksionimin e këtij programi.

III. Organizimi i studimeve

Neni 8

Studimet në Akademi organizohen në këto forma:

- Studime me kohë të plotë (të rregullta);
- Studime me kohë të pjesëshme (pa shkëputje nga puna);
- Studime online (në distancë).

Neni 9

Kolegji organizon studime bachelor në bazë të programeve të studimeve shkencore / profesionale të akredituara AKA.

Niveli i kualifikimit përcaktohet në bazë të Kornizës Nacionale të Kualifikimeve të Republikës së Kosovës.

Neni 10

Studimet shkencore / profesionale në nivelin bachelor zgjasin tre vite gjegjësisht gjashtë semestra. Me përfundimin e studimeve, studenti i grumbullon së paku 180 ECTS kredi, në varësi të programit të studimit.

Me përfundimin e suksesshëm të studimeve bachelor, fitohet thirrja akademike bachelor shkencor / profesional, varësisht prej programit dhe specializimit përkatës të kryer.

Neni 11

Në të gjitha programet, mësimi kryesisht realizohet në formë ligjëratave, ushtrimeve / mësimi laboratorike, punës praktike, rasteve të studimit, seminareve, mobiliteteve, diskutimeve, konsultime profesionale dhe nëpërmes punimeve të pavarura të studentëve.

Në lëndë të cilat kërkohet shkathtësi kreative, artistike si dhe profesionale mësimi do të organizohet në formë të studentit në qendër si psh. pjesëmarrje aktive e studentit gjatë tërë procesit mësimor, eksplotimi i kreativitetit individual në funksion të të nxërit të tij/saj, interaktivitet, me vlerësim të vazhdueshëm ku merren parasysh edhe aktivitetit gjatë semestrit, mënyra e diskutimeve gjatë procesit mësimor etj.

Neni 12

Puna praktike

Studenti, gjatë studimeve bachelor, obligohet që të ndjek mësimin praktik në semestrat e paraparë me planprogram.

Punë praktike (Internship), duhet të bëhet në bazë të rregullores për punë praktike të miratuar nga Këshilli Akademik.

Neni 13

Afatet, paraqitja dhe mbajtja e provimeve

Provimet për studime bachelor mbahen gjatë afatit të provimeve në objektin e Akademisë;

Afatet e rregullta të provimeve për student janë: Janar-Shkurt, Qershor dhe Shtator;

Këshilli Akademik në mund të vendosë edhe për organizimin e afateve jo të rregullta të provimeve.

Oraret e afateve të provimeve për studentë shpallen në fillim të vitit akademik.

Neni 14

Koha e paraqitjes së provimeve do të fillojë jo më herët se 4 javë para përfundimit ligjëratave dhe jo më vonë se 8 ditë para fillimit të mbajtjes së provimeve.

Neni 15

Nëse studentët nuk mund të hyn në provim për shkak të një arsye madhore, konsiderohet që provimi është anuluar dhe zhvendosur për një kohë të caktuar.

Në të gjitha rastet kur studenti mungon ose tërhiqet nga provimi, atëherë konsiderohet që studenti ka dështuar.

Me leje të Koordinatorit të programit studenti mund të t'i nënshtrohet provimit në një orar tjetër të përshtatshëm për studentin me qëllim që t'i mundësohet pjesëmarrja në ndonjë program ndërkombëtar për shkëmbim të studimeve, ose për të bërë mësim praktik jashtë vendit gjatë periudhës së caktuar për provim.

Neni 16

Provimet mbahen me shkrim, me gojë, prezantim të punimeve seminarike por edhe ushtrime/ mësim laboratorike praktike, vlerësim i vazhdueshëm dhe mjete tjera përcjellëse si dhe në distancë përmes platformave të përcaktuara nga Kolegji.

Provimet të cilat përbëhen prej pjesës me gojë dhe me shkrim, studenti mund të hyjë në provim me gojë vetëm atëherë kur të kalon pjesën e provimit me shkrim.

Për lëndët specifike të cilat kërkojnë shkathtësi kreative, artistike si dhe profesionale përdoret vlerësim i vazhdueshëm.

Suksesi i studentit në provim shprehet me nota prej 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë) si në vijim:

NOTA	ECTS NOTA	PIKËT	PËRKUFIZIMI
10	A	90-100	SHKËLQYESHËM/EXCELLENT
9	B	80-89	SHUMË MIRË/VERY GOOD
8	C	70-79	MIRË/GOOD
7	D	60-69	KËNAQSHËM/SATISFACTORY
6	E	50-59	MJAFTON/SUFFICIENT
5	F	0-49	DOBËT/POOR

Nota shënohet me numër dhe tekst në fletëparaqitje, procesverbal dhe SEMS.

Fletëparaqitja bashkë me procesverbalin e mbajtjes së provimit përkatës i dorëzohet administratës për të bartur në librat amë.

Mësimdhënësi është i obliguar që të shpallë rezultatet (vendos notat në SEMS) brenda 10 ditëve nga data e mbajtjes së provimit.

Neni 17

Studenti ka të drejtë t'i parashtrojë ankesë me shkrim te koordinatori i programit kundër vlerësimit të bërë nga mësimdhënësi për provimin përkatës (për provimin me shkrim, provimin me gojë apo provimin e kombinuar);

Koordinatori i programit në afatin prej 48 orësh emëron komisionin prej tre anëtarë por pa pyetësin.

Njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë i lëmisë së ngushtë me lëndën për të cilën vlerësohet studenti.

Koordinatori i programit e cakton kohën e mbajtjes së provimit në afatin prej tri ditësh nga dita e paraqitjes së ankesës së studentit – kandidatit.

Provimi me shkrim ose pjesa me shkrim e provimit mund të përsëritet para komisionit, apo të rivlerësohet nga testi i njëjtë.

Studenti nuk mund të parashtrojë ankesë kundër vlerësimit të komisionit.

Neni 18

Studenti ka të drejtë të hyjë në provim me shkrim tri herë në të njëjtin provim që nuk e ka përfunduar me sukses;

Studenti me një arsyetim të ligjshëm mund t'i lejohet nga Koordinator i programit që edhe herën e katër të hyjë në provim, pranë komisionit përkatës.

Në rast se studenti regjistrohet po në të njëjtin vit të studimeve, nuk merret parasysh numri i më parëshëm i provimeve të dështuara të studentit.

Në rast se serish dështon 4 herë në provim gjatë vitit të përsëritur, ai e humb statusin e studentit të rregullt për këtë lloj të studimeve.

IV. Përfundimi i studimeve dhe punimi i diplomës

Neni 19

Statusi i studentit të rregullt mbahet edhe 2 vite pasi studenti i ka përfunduar të gjitha provimet për tri vite të studimit.

Studenti që ka tejkaluar kohën e paraparë për të përfunduar me sukses diplomën, mund të paraqes kërkesë me shkrim te Koordinator i Programit për mundësin e zgjatjes të kësaj periudhe edhe për një vit. Nëse merret vendimi pozitiv, studenti duhet të paguaj obligimet financiare konform vendimeve të Akademisë.

Nëse punimi i diplomës mbrohet me sukses, mund të vlerësohet me notë prej 6 deri në 10 dhe ka kredi të caktuara ECTS sipas programit mësimor.

Neni 20

Zyrtarizimi i punimit të diplomës bëhet me kërkesë të studentit, e nënshkruar nga mentori. Zyrtarizimi (miratimi) i punimit të diplomës mund të bëhet vetëm atëherë kur studentit ka minus një provim të pa dhënë dhe verifikimit nga zyra e shërbimit të studentëve të Kolegjit për provimet e dhëna.

Pas miratimit të temës së punimit të diplomës nga Këshilli Akademik, caktohet komisioni vlerësues nga lëmia përkatëse prej tre anëtarëve të rregullt (mentorit dhe dy anëtarëve të tjerë nga stafi akademik) dhe një anëtar rezervë.

Neni 20

Punimi i diplomës për bachelor elaborohet individualisht nga studentit duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohet me sukses për zgjedhjen e problemeve praktike në fushën për të cilën është përcaktuar studentit.

Punimi i diplomës për bachelor mund të elaborohet bashkë nga dy ose tre studentë dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.

Kërkesa për elaborimin e punimit të diplomës nga dy ose tre studentë vendoset nga Këshilli Akademik.

Neni 21

Procedura e punimit dhe elaborimit të temës së diplomës rregullohet në detaje në Manualin e punimit të temës së diplomës për nivelin e studimeve BSc.

Tema e punimit të diplomës nuk mund të mbrohet pa kaluar 30 ditë nga data e miratimit të saj.

Tema e punimit të diplomës duhet të dorëzohet te komisioni vlerësues në 5 kopje identike, 7 ditë para mbrojtjes së saj. Tema e punimit të diplomës duhet të dorëzohet edhe në versionin elektronik së bashku me prezantimin.

Neni 23

Tema e punimit të diplomës duhet të mbrohet brenda 1 viti prej ditës së miratimit të saj.

Në rast se punimi i diplomës nuk mbrohet në afatin e paraparë, me kërkesë të justifikuar të studentit, Këshilli Akademik, mund të vazhdojë afatin edhe për 1 vit tjetër. Nëse kandidati edhe në afatin e zgjatur nuk mbron punimin e diplomës, caktohet temë e re e punimit të diplomës.

Në rast të vlerësimit negativ të mbrojtjes së punimit të diplomës, procedura e mbrojtjes mund të përsëritet pas 30 ditësh nga dita e vlerësimit negativ.

Nëse kandidati edhe pas tentimit të dytë nuk mbron punimin e diplomës, humbë të drejtën e mbrojtjes në temën e dhënë dhe duhet filluar procedurën për marrje të punimit tjetër të diplomës.

Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe mbrojtja e saj bëhet në lokalet e Kolegjit si dhe në varësi të natyrës së temës, mbrojtja mund të bëhet edhe jashtë objekteve të Kolegjit. Në raste të veçanta me pëlqimin e Këshillit Akademik, mbrojtja mund të bëhet edhe online përmes platformave virtuale të përcaktuara nga Kolegji.

V. Kushtet e regjistrimit të vitit në studime bachelor

Neni 22

Kriteret e kalueshmërisë së studentëve nga viti në vit përcaktohen nga Këshilli Akademik për çdo vit akademik.

Studentët të cilët i plotësojnë kriteret për regjistrimin e vitit Akademik, në momentin e regjistrimit duhet t'i përmbushin të gjitha obligimet financiare ndaj Kolegjit.

Neni 23

~~Studenti që nuk ka mundur ta përfundojë me sukses vitin duhet sërish të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve.~~

Numri maksimal i viteve të regjistruar sërish është i barabartë me numrin e viteve të rregullta të studimit përkatës.

VI. Kohëzgjatja e studimeve

Neni 24

Viti shkollor fillon me 1 Tetor dhe zgjatë deri me 30 Shtator të vitit të ardhshëm,

Mësimi në studimet themelore zhvillohet në 15 javë. Në një semestër studenti mund të ketë së paku 5 lëndë mësimore e më së shumti 7 lëndë të cilat duhet të korrespondojnë me 30 ECTS kredi.

Numri i tërësishëm i lëndëve zgjedhore të cilat u ofrohen studentëve për t'i zgjedhur nuk mund të jetë më i madh se dyfishi i lëndëve zgjedhore që duhet të zgjidhen.

Orari i ligjëratave nxirret në fillim të vitit akademik dhe pas publikimit të tij është i obligueshëm për mësimdhënësit dhe studentët.

Ngarkesa vjetore e studentit me ligjërata, ushtrime, përgatitje dhe të tjera është 750 orë në semestër, respektivisht 1500 orë në vit, që korrespondon me 30 ECTS kredi në semestër apo 60 ECTS kredi në vit. Çdo ECTS kredi është e barabartë me 25 orë angazhim të studentit.

Neni 25

Studenti duhet t'i përfundon studimet në Kolegj brenda një periudhe që nuk tejkalon dyfishin e periudhës normale të paraparë për studimet të cilat i ka regjistruar, me përjashtim të rasteve të veçanta për të cilat vendosë Këshilli Akademik.

VII. Statusi i studentit

Neni 26

Statusin e studentit një person (individi) e fiton me rastin e regjistrimit në programet e studimeve të cilat i ofron Kolegjit, dhe i plotëson detyrimet e veta akademike dhe financiare në pajtim me ligjim për Arsimin e Lartë, Statutin dhe aktet tjera të përgjithshme të Kolegjit.

Studenti, Statusin e vet e dëshmon me kartelën e studentit, e cila posedon numrin identifikues sipas regjistrimit në Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Studentëve SEMS.

Formën dhe përmbajtjen e dokumentit nga pika 2 e këtij neni e përcakton Kolegjit në përputhje me legjislacionin e MASHTI.

Neni 27

Nëse studenti e humbë kartelën, administrata (shërbimi i studentëve) në bazë të shënimeve zyrtare dhe me njoftim të Koordinatorit të programit, ia jep kartelën dublikate e që i përgjigjet dokumentit të humbur.

Studenti së bashku me kërkesë i bashkëngjit edhe fletë dëshminë se dokumenti është shpallur i pavlefshëm, dhe dëftesën mbi pagimin e shpenzimeve për lëshimin e kartelës dublikate.

Studenti që i ka përbush të gjitha detyrimet e parapara me planin dhe programin mësimor në pajtim me Statutin e Akademisë, fiton të drejtën për t'u regjistruar në vitin pasues të studimeve.

Neni 28

Studenti e humb statusin e studentit në këto raste:

- Kur vendos të largohet nga studimet;
- Kur i ka përfunduar studimet;
- Kur nuk i ka përfunduar studimet në peridhën e dyfishitë të kohëzgjatjes së studimeve;
- Me vendim të Akademisë mbi procedurën disiplinore, si dhe raste tjera që parashihen me ligj, statut dhe aktet të tjera normative.

Neni 29

Studenti mund të kërkojë ndërprerje të përkohshme të studimeve dhe përgjegjësitë që dalin me statusin e studentit të rregullt në rastet e dëshmuar si:

- Sëmundjes së rëndë;
- Kujdesi për fëmijën nën moshën tre vjeçare;
- Shtatzënisë lehonisë së studentes, si dhe
- Rastet të tjera të parapara me ligj dhe statut të Kolegjit.

VIII. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Neni 30

Studentët e pranuar në Kolegji kanë këto të drejta:

- Të marrin pjesë në ligjërata, seminare, ushtrime teorike, ushtrime praktike laboratorike dhe në teren, mobilitete, hulumtime, diskutime, konsultime profesionale dhe format tjera të mësimi sipas plan-programit në fuqi;
- Të shfrytëzojnë bibliotekën e Kolegjit, hapësirën fizike dhe pajisjet tjera teknike si internetin, laboratorët, kompjuterët etj.

Të marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit e studentëve në organet përfaqësuese të Kolegjit dhe të studentëve, si dhe të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku janë caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e besuara në organet e Kolegjit;

- Të marrin pjesë në aktivitetet kulturore e sportive, seminare profesionale, konferenca dhe tubime të studentëve;
- Të marrin pjesë në konkurs për çmimin student i dalluar dhe bursist i Kolegjit si dhe të drejta të ndërlidhura me to, që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen aktive dhe kritike të studentit.

Neni 31

Studentët kanë këto obligime:

- Ti zbatojnë rregullat e përcaktuara nga Kolegjit;
- Të respektojnë të drejtat e personelit dhe studentëve të tjerë;
- Të kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
- Të vijojnë ligjëratat në pajtim me rregullat e programit specifike të studimeve;
- Të tregojnë kulturë njerëzore dhe akademike në ambientet e Kolegjit ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskredituar Kolegjit.

Neni 32

Diplomat për kryrjen e studimeve bachelor i nënshkruan Drejtori i Kolegjit.

Përmbajtjen dhe formën e diplomës e përcakton MASHTI.

IX. Dispozitat kalimtare

Neni 33

Për çështjet të cilat nuk janë përfshi me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës dhe Statutit të Kolegjit.

Neni 34

Studentët të cilët nuk i kanë kryer studimet në periudhën e paraparë, mund t'i vazhdojnë studimet sipas rregullave të studimeve të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 35

Kjo rregullore hyjnë në fuqi nga dita e miratimit nga Këshilli Akademik i Kolegjit.

Neni 36

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja për studime bachelor nr.008/23 e datës 10.10.2023.

Kryesuesi i Këshillit Akademik

Dr.Sc.Mevlan Bixhalaj



